



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

07-10-2014

01-013/1379

Titulli / Prokurimi / Mbrojtja	Numri / Seria	Vlera / Vlerësimi	Vlera / Vlerësimi



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në pajtim me dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), nenit 38 të Ligjit për Ndërtim nr 04/L- 110 të datës 31.05.2012, lidhur me zbatimin e dispozitave të neneve 22, 49 dhe 51 të Ligjit nr. 2004/15 për Ndërtim në Kosovë, të nenit 35, paragrafi 35.2, pika **a**, të Statutit të Komunës së Vitisë 01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 29.09.2014 aprovon këtë:

## V E N D I M

### PËR LLOGARITJEN DHE KOMPENSIMIN PËR PRANIMIN TEKNIK TË OBJEKTEVE

#### I

Miratohet Vendimi për llogaritjen dhe kompensimin për pranimin teknik të objekteve në Komunën e Vitisë.

#### II

Komisioni për pranim teknik do të formohet në bazë të Ligjit për Ndërtim nr. 04/L- 110 të datës 31.05.2012, lidhur me zbatimin e dispozitave të neneve 22, 49 dhe 51 të Ligjit për Ndërtim nr. 2004/15 dhe Udhëzimit administrativ me nr. rendor 68, nr. i protokollit 29/05.

#### III

Në punën e Komisionit për kontrollin teknik, caktohen personat profesionalë nga lëmenjtë përkatës, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara ligjore sipas ligjit të përmendur në pikën II të këtij Vendimi.

#### IV

Baza për llogaritjen e kompensimit për punën e Komisionit nga pika **III** e këtij Vendimi, do të jetë si më poshtë:

Nr. rendor	Vlera e investimit	Pranimi teknik %
1	Deri në 200,000 €	0,80
2	200,001 – 500,000 €	0,70
3	500,001 – 1,000,000 €	0,60
4	1,000, 001 – 5,000,000 €	0,50
5	Mbi 5,000,000 €	0,40

Shuma përkatëse paguhet nga investitori në llogari të Komunës, me rastin e kërkesës për pranimin teknik të objektit, dhe pas pranimit teknik të objektit kjo shumë iu bartet Komisionit për pranim teknik.

Kontrollimi teknik do të kryhet jashtë orarit të rregullt të punës.

Llogaritja e pagesës për punën e Komisionit bëhet sipas shpërndarjes të përshkruar më poshtë:

Kryetari i Komisionit	0.17 x totali për komision
Arkitektura	0.16 x totali për komision
Statika	0.16 x totali për komision
Elektrika	0.10 x totali për komision
Uji dhe Kanalizimi	0.10 x totali për komision
Ngrohja dhe Klimatizimi	0.10 x totali për komision
Mbrojtja nga zjarri	0.10 x totali për komision
Gjeodet	0.10 x totali për komision
Personi juridik	0.10 x totali për komision

#### V

Shpenzimet për pranim teknik, sipas tabelës së mësipërme, i bart investitori.

#### VI

Shpenzimet për pranim teknik, të cilat përsëriten për moseliminimin e vërejtjeve të dhëna nga Komisioni, i bart investitori dhe vlera e tyre do të jetë 70% e vlerës së Komisionit të parë.

#### VII

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

#### VIII

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

